

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	616-25-2547-1-1-1
Nr i brendshëm	616-25-77-1-1-1

Sa i përket tenderit për: **"163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet" - Ritender**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

G.O.E. "EING COM" SH.P.K. & "MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI" A.S.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dumosh, Podujevë, 11000
(Vendi, Kodi postar)

+383 49 263 052
(Numri Telefonit)

Eljesah PODVORICA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@eing-ks.com
(Adresa elektronike)

27.08.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Ankesa parashtrohet nga përfaqësuesi i autorizuar i G.O.E. "EING COM" SH.P.K. & "MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI" A.S.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- 28.03.2025 – Data e publikuar e Njoftimit për Kontratë
- 22.04.2025 – Afati i fundit për Dorëzimin e Tenderëve.
- 27.05.2025 – Letër standarde për sqarimin e dokumenteve të prezentuara.
- 10.06.2025 - Letër Standarde për Tenderuesin e Eleminuar
- 10.06.2025 - Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare
- 16.06.2025 – Kërkesë për rishqyrtim
- 18.06.2025 – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim
- 26.06.2025 – Ankesa ne OSHP
- 19.08.2025 – Vendimi i OSHP-se për kthim në rivlersim të lendes
- 31.12.2025 - Letër Standarde për Tenderuesin e Eleminuar
- 31.12.2025 - Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare
- 05.01.2026 – Kërkesë për rishqyrtim
- 08.01.2025 – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim
- 10.01.2026 – Ankesa ne OSHP
- 26.02.2026 – Vendimi i OSHP-se për kthim në rivlersim të lendes
- 28.04.2026 - Letër Standarde për Tenderuesin e Eleminuar
- 04.05.2026 - Kërkesë për rishqyrtim
- 05.05.2026 – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim
- 13.05.2026 – Ankesa ne OSHP
- 06.07.2026 - Vendimi i OSHP-se për kthim në rivlersim të lendes
- 28.07.2026 - Vendim për Diskualifikim
- 07.08.2026 - Letër Standarde për Tenderuesin e Eleminuar dhe anulim të procedurës
- 07.08.2026 - Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare
- 11.08.2026 – Përgjigje për mos dhënie në qasje në dokumentet e kerkuara

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk ka vërejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues gjate vleresimit dhe krahasimit per kete aktivitet te prokurimit keni bere shkelje ligjore te dispozitave te ketij ligji duke na eliminuar neve si GOE te pergjegjshem dhe duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit.

Per me teper te katër vendimet e OSHP-se te cilat nderlidhen me lenden ne fjale perkatesisht vendimet nr: 535/2025 i dates: 19.08.2025, 027/2026 i datës: 26.02.2026, 0311/2026 i datës: 06.07.2026 dhe 676/2026 i datës: 28.07.2026, Vërtetojn se jemi GOE i vetem i pergjegjshem ne kete procedur te prokurimit dhe kete e deshmojn vendimet e lartecekura nga OSHP.

Prandaj kerkojm nga KK.Prishtine ta korigjoj vendimin e publikuar me datë: 07.08.2026, dhe ti merr parasysh Vendimet e OSHP-se si dhe faktet dhe argumentet e paraqitura nga ana jonë.

AK ka bere shkelje te dispozitave si me poshtë:

1. Neni 1 - Qëllimi i LPP-së
2. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
3. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
4. Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
5. Neni 62 i LPP-së – Anulimi i procedures
6. Neni 69 - Aftesia teknike dhe/ose profesionale
7. Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
8. Neni 40.2.1 I RRPP-së - **Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve.**
9. Neni 43 i RRPP-së – Anulimi i procedures

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë: 07.08.2026 nga KK.Prishtinë jemi njoftuar përmes Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, vendim tendencioz dhe krejtësisht pa bazuar dhe i paargumentuar.

Ne si GOE nuk pajtohemi me kete vleresim dhe vendim te AK, sepse konsiderojme se AK na ka eliminuar pa te drejte duke qene se jemi te vetmit GOE te pergjegjshem ne kete procedur te prokurimit.

Për me teper AK per te treten here me radhe nuk respekton Vendimet e OSHP-se pavarsisht se me dispozitat e legjistacionit per prokurim publik percaktohet qarte, se kur lenda kthehet ne ri-vlersim sipas vendimit te OSHP-se ri-vlersimi duhet te behet ne perputhje me vendimin e OSHP-se dhe rekomandimet e dhena ne ate vendim. Shih Nenin 40.2.1 I RRPP-së .

Neni 40.2.1 I RRPP-së, percakton: “Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një kërkesë të OE për rishqyrtim të vendimit të AK-së, AK e kthen lëndën në rivlerësim për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore. **Kurdo që aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim në bazë të një vendimi të OSHP-së, rivlerësimi bëhet për të korigjur parregullsitë e mundshme ligjore sipas vendimit të OSHP-së. Rivlerësimi i tenderëve mund të bëhet nga i njëjti komision, i cili ka kryer vlerësimin e tenderëve**”.

Pra me dispoziten e lartecituar shihet qarte se kur lenda kthehet në rivlerësim sipas vendimit të OSHP-se, AK është i obliguar ta respektoj vendimin e OSHP-se në perpikmeri. Në rastin konkret AK nuk e respekton vendimin e OSHP-se perkundrazi vazhdon të sajtoj pretendime të paqena vetëm që ta zvarris dhe ta komprometoj këtë aktivitet të prokurimit duke bërë shkelje sistematike të Legjistacionit për Prokurim Publik.

AK- ZPP ka bërë shkelje të rënde të legjistacionit për prokurim publik, duke mos zbatuar vendimet e OSHP-se. Prandaj, këto veprime të AK-se – ZPP-se klasifikohen si shkelje të rënde të Rregullave në Prokurimin Publik perkatesisht rregullat e percaktuara me Nenin 97 pika h dhe Rregullores për Prokurim Publik:

- *(h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së).*

Gjithashtu AK me veprimet e saj ka bërë shkelje edhe të qeshtë e pikes c dhe k të Rregullores për Prokurim Publik perkatesisht të nenit 97 të kesaj Rregullore:

- *“c. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.*
- *k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik”.*

Mos zbatimi i vendimit të OSHP-se nga ana e autoritetit kontraktues ZPP KK Prishtine është bërë praktike e zakonshme e cila sjell pasoja ekonomike dhe juridike për ne duke na vështësuar marrin pjesë në procedurat e prokurimit të publikuara nga autoriteti kontraktues KK. Prishtine.

Me këtë vendim shihet qarte se AK, perkatesisht ZPP ka bërë shkelje të Legjistacionit për Prokurim Publik, po ashtu ka bërë shkelje të parimeve baze të LPP-së duke mos respektuar këto vendime të **OSHP-se nr: 535/2025 i datës: 19.08.2025, 027/2026 i datës: 26.02.2026, 0311/2026 i datës: 06.07.2026 dhe 676/2026 i datës: 28.07.2026**, të cilat Vërtetojnë se jemi GOE i vetëm i pergjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit.

Të gjitha pretendimet të paraqitura në njoftimin mbi vendimin e AK-se kundrejt neve si GOE janë të paqëndrueshme dhe këto e vërtetojnë Vendimet e OSHP-se, prandaj të gjitha pretendimet e lartecitura ndaj neve janë të gjykuara nga paneli shqyrtues. Ndersa, sa i përket pretendimit të cila lidhet me Raportin e Inspektimit “Inspection Report Nr. 314 R” është sqaruar me datën 02.06.2025 sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Prandaj kjo ankese duhet të trajtohet si RES JUDICATA Neni 105 pika 2.16 e LPP-se.

Gjithahstu kërkojme nga OSHP te ndermerr masa ndaj autoritetit kontraktues ne detyrimin e respektimit te vendimit te OSHP-se sepse vazhdimi i mos zbatimit te vendimeve te OSHP-se krijon pasiguri juridike dhe deformim te procesit te prokurimit.

Ne te kunderten per mos respektim te vendimit te OSHP-se, OSHP të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - “Komuna e Prishtinës”, në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së, sepse kjo nuk është hera e parë që Komuna e Prishtinës/Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i zbaton vendimet e OSHP, me çrast ne per te disaten here dergojm ankes ne OSHP per pretendimet e njejta ankimore nga palët e njejta. Këto veprime janë në kundërshtim fillimisht me neni 1 të LPP, duke prolonguar qëllimisht aktivitetet e prokurimit, po ashtu janë në kundërshtim edhe me nenin 6 dhe 7 të LPP.

Ndersa pretendimet e ngritura ne vendimin e radhes se AK-se i kundërshtojm sepse i gjithë ky arsyetim i AK-se paraqitet pa prova dhe pa argumente duke mos perfillur fare vendimet e OSHP-së.

Ne si GOE “EING COM” SH.P.K. & “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.Ş. kundërshtojm në tërësi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, të datës 07.08.2026, sepse eliminimi ynë dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit janë bërë pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e legjistacionit per prokurim publik.

Me poshte po paraqesim aspektin kronologjik, arsyet e eliminimit tone ne kete aktivitet te prokurimit:

Pretendimi 1:

Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendime me përfundime mbi bazën e dyshimeve dhe hamendësimeve, pa identifikuar dhe administruar prova konkrete që do të dëshmonin papërgjegjshmërinë e ofertës sonë duke e ditur qe kete pike per kete qeshtje e kemi sqaruar per AK me date: 02.06.2025. Per me teper sa i perket sqarimit te dokumentit ne fjale i kemi paraqitur te dhenat e adresimit ku mund të verifikohen në mënyrë të besueshme ky dokument me te gjitha elementet e nevojshme. Prandaj AK ka mundur lehtesisht te kerkon sqarime ose edhe ta verifikon vet me qenese te gjitha sqarimet per kete qeshtje i kemi ofruar te AK.

Siq shihet ne arsyen e dhene nga AK, ku thuhet se: Mungesa e përgjigjes brenda afatit të njëanshëm prej tri ditësh, të caktuar nga vetë AK-ja, nuk përbën provë se dokumenti është i pavlefshëm, joautentik apo i papërshtatshëm. Për më tepër, AK nuk ka identifikuar se cilat janë “provat dhe informacionet e tjera relevante” mbi të cilat pretendon se e ka mbështetur këtë përfundim, duke qenese dokumenti eshte i prezentuar se bashku ne oferten ton dhe per te njejtin kemi dhene sqarime me date: 02.06.2025.

Gjithesesi me qenese keto dokumente sigurohen nga nje pale e trete jashte Kosoves dhe ne kemi kerkuar edhe njehere ta na i rikonfirmojn te nejtat dokumente, leshuesit te dokumenteve perkatese dhe ne momentin e pranimit do i bashkangjesim edhe njehere per ta sqaruar per ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues.

Çështja e dokumentit tatimor:

Lidhur me kete AK duhet ta kete te qarte se kjo qeshjte eshte trajtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, me c'rast ka Vendim perfundimtar lidhur me kete qeshtje dhe eshte e pakuptimt te vazhdohet me keto pretendime te pagena dhe tendencioze.

Kjo çështje është shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimin e OSHP-së PSH.nr.676/26, ku kërkesa e AK-së për diskualifikimin e GOE-së është refuzuar si e pabazuar.

Po ashtu, vendimi OSHP:2026/0311 ka trajtuar natyrën dhe fazën procedurale të dokumentit tatimor, duke konstatuar se dëshmitë e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së kërkohen nga tenderuesi që AK synon ta rekomandojë për kontratë, para publikimit të B58-së. Sipas këtij vendimi, dokumenti nuk është dashur të përdoret si kriter i drejtpërdrejtë eliminues pa u respektuar procedura për kërkimin, dorëzimin dhe verifikimin e dëshmive të pranueshmërisë. Vendimi zyrtar OSHP:2026/0311 ashtu siq është potencuar në këtë vendim.

Prandaj, AK jo vetëm që po përsërit një pretendim të trajtuar më parë, por po përdor përsëri të njëjtën çështje si bazë për eliminim, në kundërshtim me konstatimet dhe udhëzimet e OSHP-së.

Provë 1:



T.C.
HAZİNE VE MALİYE BAKANLIĞI
Gelir İdaresi Başkanlığı
Dijital Vergi Dairesi



Başvuru Tarihi : 27/05/2025
Sayı : 6wmb4yaklml16s
Konu : Vadesi Geçmiş Borç Durumunu
Gösterir Belge (KİK)

Düzenleme Tarihi: 27/05/2025⁽¹⁾

EING COM L.L.C

Aşağıda bilgileri yer alan mükellefin 27/05/2025 tarihi itibarıyla vadesi geçmiş borcunun bulunmadığı kayıtlarımızın tetkikinden anlaşılmıştır.

Bu belge, 4734 sayılı Kamu İhale Kanununun 10 uncu maddesinin dördüncü fıkrasının (d) bendi kapsamında verilmiştir.

Bilgilerinize arz/rica olunur.

Tasdik Eden

34 - Tuzla 34 - Rıhtım 34 - Pendik 34 - Nakil Vasıta

Adı Soyadı : Mavi Deniz Çevre Hizmetleri Anonim Şirketi
Vergi Kimlik Numarası : 6130463468
İşyeri Adresi : Güzelyalı Mah. Yeni Türkü Sk. Dörtler Hidrolik No:10/ 1 Pendik/ İstanbul

(1) Bu belgenin tanzim edildiği tarihtir.

Bu yazı Dijital Vergi Dairesi tarafından oluşturulmuştur. Yazının doğruluğunu <https://dijital.gib.gov.tr/dogrulamalar/mukellefiyetDogrulama> adresinde yer alan **DOĞRULAMALAR/Mükellefiyet Yazısı/ Borç Durum Yazısı Doğrulama** alanından şifre gereksizsiniz sayı ve Vergi/T.C. Kimlik Numarası bilgisi ile belgeyi görüntülemek suretiyle doğrulayabilirsiniz.

Provë 2:

T.C.
HAZİNE VE MALİYE BAKANLIĞI
Gelir İdaresi Başkanlığı
Dijital Vergi Dairesi



Başvuru Tarihi : 25/08/2025
Sayı : 3qmemk2e6f1wlu
Konu : Vadesi Geçmiş Borç Durumunu
Gösterir Belge (DİĞER)

Düzenleme Tarihi: 25/08/2025⁽¹⁾

EING COM L.L.C

Aşağıda bilgileri yer alan mükellefin 25/08/2025 tarihi itibarıyla vadesi geçmiş borcunun bulunmadığı kayıtlarımızın tetkikinden anlaşılmıştır.

Bilgilerinize arz/rica olunur.

Tasdik Eden

34 - Tuzla 34 - Rıhtım 34 - Pendik 34 - Nakil Vasıta

Adı Soyadı : Mavi Deniz Çevre Hizmetleri Anonim Şirketi
Vergi Kimlik Numarası : 6130463468

(1) Bu belgenin tanzim edildiği tarihtir.

Bu yazı Dijital Vergi Dairesi tarafından oluşturulmuştur. Yazının doğruluğunu <https://dijital.gib.gov.tr/dogrulamalar/mukellefiyetDogrulama> adresinde yer alan DOĞRULAMALAR/Mükellefiyet Yazısı/ Borç Durum Yazısı Doğrulama alanından şifre gereksizsin sayı ve Vergi/T.C. Kimlik Numarası bilgisi ile belgeyi görüntülemek suretiyle doğrulayabilirsiniz.

Provë 3:

T.R.
MINISTRY OF TREASURY AND FINANCE
Revenue Administration
Digital Tax Office



Application Date: 27/02/2026
Number : 5jmm3h791p1iwd
Subject : Document Showing Overdue
Debt Status. (6183 S.K. 22/A)

Date of issue: 27/02/2026⁽¹⁾

EING COM L.L.C

Our records show that the taxpayer whose information is provided below has no overdue debts are of 27/02/2026, under Article 22/A of Law No. 6183.

This information is provided / requested for your consideration.

Confirming

34 - Tuzla 34 - Rıhtım 34 - Pendik 34 - Nakil Vasıta

Name : MAVİ DENİZ ÇEVRE HİZMETLERİ ANONİM ŞİRKETİ
Tax Identification Number : 6130463468

(1) This document is valid for 15 days from the date of its issuance.

Bu yazı Dijital Vergi Dairesi tarafından oluşturulmuştur. Yazının doğruluğunu <https://dijital.gib.gov.tr/dogrulamalar/mukellefiyetDogrulama> adresinde yer alan DOĞRULAMALAR/Mükellefiyet Yazısı/ Borç Durum Yazısı Doğrulama alanından şifre gereksizsin sayı ve Vergi/T.C. Kimlik Numarası bilgisi ile belgeyi görüntülemek suretiyle doğrulayabilirsiniz.

Provë 4:

REPUBLIC OF TÜRKİYE
MINISTRY OF TREASURY AND FINANCE
Revenue Administration
Digital Tax Office



Application Date: 25/06/2026

Issue Date: 25/06/2026⁽¹⁾

Number : 5emqrobu1vih

Subject : Vadesi Geçmiş Borç Durumunu
Gösterir Belge (DİĞER)

EING COM LLC

An examination of our records indicates that the taxpayer, whose details are provided below, has no overdue debt as of June 25, 2026.

Submitted for your information.

Certifying

34 - Tuzla

34 - Rıhtım

34 - Pendik

34 - Nakil Vasıta

Name : MAVİ DENİZ ÇEVRE HİZMETLERİ ANONİM ŞİRKETİ

Tax Identification Number : 6130463468

(1) This is the date on which this document was drawn up.

This document has been generated by the Digital Tax Office. You can verify its authenticity without a password by visiting <https://dijital.gib.gov.tr/dogrulamalar/mukellefiyetDogrulama> and using the document number along with the Tax ID or T.R. Identity Number to view the document.

Pretendimi 3:

Kundërshtimi i arsyes për mungesë të mjeteve financiare

Nuk qëndron as pretendimi i AK-së se për vitin fiskal 2026 “nuk janë të alokuara mjete financiare” për realizimin e këtij projekti, duke qenëse gjatë inicimit të aktivitetit të prokurimit kerkohet rreptesisht qe:

Neni 8.1 i RRPP-se percakton:

Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nga ana e Autoriteteve kontraktuese bëhet në pajtueshmëri me Nenit 9 të LPP-së. Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që:

a. Fondet janë alokuar; ose

b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike. “Alokimi” do të thotë këtu “shuma është autorizuar”, në mënyrë që të jetë në përputhje me buxhetin dhe sistemin e pagesave. Qëllimi i sigurimit të fondeve të alokuar është që të përmirësohet efikasiteti, pasi që inicimi i një procedure të prokurimit për të cilën nuk ka fonde të alokuar thjesht mund të jetë humbje e resurseve.

Prandaj mbi kete baze AK ka inicuar kete aktivite te prokurimit duke u mbeshtetur ne dispizitat perkatese dhe kjo provë e paraqitur nga ana jone e kundërshton drejtpërdrejt konstatimin e AK-së se nuk ekzistojnë mjete të alokuara për këtë projekt.

AK ka perdorur si argument procedurat e shqyrtimit te OSHP-se si fakt per rrethana te reja duke qense i gjith ky proces eshte zvarrit nga ana juaj per te krijuar situata te tilla dhe kjo eshte e papranueshme duke qene se kater Vendime te OSHP-se nuk i ka zbatuar dhe kjo perben shkelje te rende te dispozitave ligjore per prokurimin publik.

Provë 4 – Ky projekt është përfshirë në Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2026, në këtë kategori:

Kategoria: Investime kapitale

Drejtoria: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Pozicioni: Nr. 10

Emërtimi: “Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”

Buxheti total për vitin 2026: 500,000.00 €

200,000.00 € nga Granti i Përgjithshëm

300,000.00 € nga Burimet Vetanake

Pra, aktiviteti i prokurimit me vlerë të parashikuar 2,000,000.00 € mbështetet në vitin 2026 me ndarje buxhetore prej 500,000.00 €. Diferenca duhet të mbulohet përmes zotimeve shumëvjeçare ose buxheteve të viteve pasuese, varësisht nga kontrata dhe planifikimi financiar.

Po ashtu mosdhënia e qasjes në dokumente na bene te dyshojm ne gjith kete proces te inskenuar nga autoriteti kontraktues me situata dhe rrethana te paqena.

Prandaj bazuar ne sqarimet e dhena me larte, kërkojmë nga ekspertit shqyrtues dhe paneli shqyrtues që ta kthej lënden në rivlerësim si dhe ta detyroj dhe ta Urdheroj Autoritin Kontraktues qe ta beje Ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave te nenit 59 te LPP-se si dhe konfrom vendimeve te OSHP-se.

-----**perfundim i pretendimeve ankimore**-----

Kërkojm nga OSHP të merr vendim me të cilin:

- I. APROVOHET** si e bazuar ANKESA e G.O.E.“EING COM” SH.P.K. & “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.S.
- II. ANULOHET** B58-Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt: 07.08.2026
- III. Lënda të kthehet në RIVLERËSIM** duke respektuar Vendimet e OSHP-se dhe te marrë në konsiderat të gjitha sqarimet e dhena nga ana jone.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

G.O.E. "EING COM" SH.P.K. & "MAVI DENIZ ÇEVRE HİZMETLERİ" A.S. në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, dhe Kërkesës për kompensimin e dëmeve, duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara me larte.